



INSTITUCIONI I OMBUDSPERSONIT NË KOSOVË

RAPORTI SPECIAL NR. 13

mbi

**Dështimin e Autoriteteve Komunale në Skenderaj/Srbica dhe
Mitrovicë/Mitrovica për të bashkëpunuar me
Institucionin e Ombudspersonit në Kosovë**

drejtuar

Kuvendit të Kosovës

Ombudspersoni në Kosovë, në pajtim me nenin 4.1 paragrafët (b) dhe (f) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/6 mbi Institucionin e Ombudspersonit në Kosovë dhe Rregullat 18 dhe 19 të Rregullave Procedurale të Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë, më 22 maj 2007 ka publikuar raportin në vijim:

pdfMachine

Is a pdf writer that produces quality PDF files with ease!

Produce quality PDF files in seconds and preserve the integrity of your original documents. Compatible across nearly all Windows platforms, if you can print from a windows application you can use pdfMachine.

Get yours now!

BAZA PËR RAPORTIN

1. Ky raport bazohet në letrat dhe kërkesat gojore të ish-Ombudspersonit dhe më vonë edhe të Ushtruesit të Detyrës së Ombudspersonit, si dhe të personelit të Institucionit të Ombudspersonit, që i janë bërë autoriteteve komunale në Skenderaj/Srbica gjatë periudhës kohore prej 16 shtator 2005 deri 23 prill 2005 dhe autoriteteve komunale në Mitrovicë/Mitrovica gjatë periudhës kohore prej 9 shtator 2005 deri 16 mars 2007.

QËLLIMI I RAPORTIT

2. Ky raport shqyrton pajtueshmërinë e mosveprimit të autoriteteve komunale të lartpërmendura, me nenet 4.5 dhe 4.8 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/06 mbi Institucionin e Ombudspersonit në Kosovë, në bazë të të cilave, autoritetet publike duhet të bashkëpunojnë me Institucionin e Ombudspersonit në Kosovë dhe t'i përgjigjen kërkesave të tija brenda një kohe të arsyeshme.

HEQJA DORË NGA PËRGJEGJËSIA

3. Asgjë nga përmbajtja e këtij Raporti Special nuk duhet nënkuptuar si heqje dorë të Ombudspersonit nga e drejta e tij për të hetuar ankesat e individëve që pohojnë shkeljet e të drejtave të njeriut apo keqpërdorimet e pushtetit rreth çështjeve lidhur me ligjin dhe praktikën e lartpërmendur ose të shqyrtojë dekretet e ngjashme ligjore për pajtueshmërinë e tyre me standardet e njohura ndërkombëtare. Ombudspersoni i rezervon të gjitha të drejtat për të ushtruar juridiksionin e tij lidhur me këto ose çështje tjera të ngjashme.

PRAPAVIJA

Komuna e Skenderajt/Srbica

4. Më 16 shtator 2005, ish-Ombudspersoni i dërgoi letër Drejtorit të Drejtorisë për Arsim në Komunën e Skenderajt/Srbica, me të cilën e informoi atë lidhur me një ankesë nga një ish-mësues i shkollës fillore, lidhur me përjashtimin e tij nga puna dhe ndërprerjen e pagës së tij. Sipas pohimeve, të dy veprimet janë ndërmarrë pa i dhënë ankuesit ndonjë vendim paraprak para vendimit përfundimtar nga Drejtoria e Shkollës Fillore, përkundër faktit se ai kishte punuar që nga viti 1958. Me këtë letër, ish-Ombudspersoni ka kërkuar që të merr informata lidhur me rastin e ankuesit, por jo më vonë se 30 shtator 2005. (CR. Nr.1016/05), mirëpo nuk ka pranuar asnjë përgjigje në këtë letër, përkundër faktit se përfaqësuesi i Institucionit të Ombudspersonit ka kontaktuar disa herë me Drejtorin e Drejtorisë Komunale për Arsim në Komunën e Skenderajt/Srbica.
5. Më 25 nëntor 2005, ish-Ombudspersoni i dërgoi letër Drejtorit të Drejtorisë Komunale për Arsim në Skenderaj/Srbica, më të cilën ai vuri në pah çështjen e mosekzekutimit të vendimit të datës 13 shtator 2005, të lëshuar nga Komisioni Komunal për Ankesa, me të cilin është aprovuar ankesa e ankuesit e datës 30 shtator 2005. Me këtë letër, ish-Ombudspersoni ka kërkuar që Komisioni Komunal për Ankesa të marrë parasysh kërkesën e ankuesit për të marrë vendim për të anuluar vendimin e Komisionit Komunal për Ankesa të datës 13 shtator 2005.

pdfMachine

Is a pdf writer that produces quality PDF files with ease!

Produce quality PDF files in seconds and preserve the integrity of your original documents. Compatible across nearly all Windows platforms, if you can print from a windows application you can use pdfMachine.

Get yours now!

Skenderaj/Srbica ishte urdhëruar që ankuesit t'i jepen pagat, duke filluar që nga 1 marsi 2005 (Regjistrim i Përkohshëm 1194/05). Ish-Ombudspersoni kërkoi informata lidhur me rastin e ankuesit jo më vonë se deri më 9 dhjetor 2005, por nuk pranoi përgjigje në këtë letër.

6. Më 23 dhjetor 2005, ish-Ombudspersoni i dërgoi letër përkujtuese Drejtorit të Drejtorisë Komunale për Arsim në Skenderaj/Srbica. Një kopje e kësaj letre iu dërgua edhe Kryetarit të Asamblesë Komunale në Skenderaj/Srbica. Ish-Ombudspersoni kërkoi informata lidhur me rastin e ankuesit jo më vonë se deri më 6 janar 2006, por sërish nuk pranoi asnjë përgjigje në letrën e tij.
7. Më 13 shkurt 2006, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit i dërgoi një letër Ministrit për Qeverisje Lokale dhe Ministrit për Arsim, Shkencë dhe Teknologji, me të cilën i informoi ata se autoritetet komunale në Skenderaj/Srbica kanë dështuar të përgjigjen në letrat e ish-Ombudspersonit dhe të Ushtruesit të Detyrës së Ombudspersonit. Ai kërkoi nga ata që të sigurojnë që kjo praktikë të ndërpritet, kështu që në të ardhmen, Institucioni i Ombudspersonit t'i merr informatat e kërkuara. Një kopje e kësaj letre i është dërguar Koordinatorit për Standarde në Qeverinë e Kosovës dhe Kryetarit të Komunës së Skenderajt/Srbica. Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit nuk ka pranuar asnjë përgjigje në këtë letër.
8. Më 26 maj 2006, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit i ka hapur formalisht hetimet në lidhje me rastin (Regjistrimi nr. 1016/05).
9. Në mes muajve maj 2006 dhe shkurt 2007, përfaqësuesit e Institucionit të Ombudspersonit patën disa takime me ankuesin. Secilën herë, ai pohoi se Drejtori i Drejtorisë për Arsim në Komunën e Skenderajt/Srbica, ende nuk e kishte zbatuar vendimin e Komisionit Komunal për Ankesa (shih paragrafin 5 më lartë).
10. Më 29 mars 2007, përfaqësuesit e Institucionit të Ombudspersonit janë takuar me Drejtorin e Drejtorisë për Arsim në Komunën e Skenderajt/Srbica dhe e kanë pyetur atë lidhur me rastin e ankuesit. Drejtori i Drejtorisë tha se nuk kishte asnjë informatë lidhur me rastin e ankuesit.
11. Më 18 prill 2007, përfaqësuesit e Institucionit të Ombudspersonit, përsëri u takuan me Drejtorin e Drejtorisë për Arsim në Komunën e Skenderajt/Srbica dhe e pyetën lidhur me rastin e ankuesit. Përsëri, Drejtori i Drejtorisë tha se nuk kishte asnjë informatë lidhur me rastin e ankuesit.

Komuna e Mitrovicës/Mitrovica

12. Më 9 shtator 2005, ish-Ombudspersoni i dërgoi një letër Drejtorit të Drejtorisë për Urbanizëm në Komunën e Mitrovicës/Mitrovica, me të cilën e informoi atë lidhur me një ankesë që e kishte pranuar nga pronari i një shtëpie, i cili sipas një vendimi, ishte penguar që ta shfrytëzojë lirshëm pronën e tij, ndërsa një personit tjetër i ishte lejuar që të ndërtojë një hotel para shtëpisë së ankuesit (CR. Nr.1016/05). Ish-Ombudspersoni kurrë nuk pranoi përgjigje në këtë letër të datës 09 shtator 2005.

pdfMachine

Is a pdf writer that produces quality PDF files with ease!

Produce quality PDF files in seconds and preserve the integrity of your original documents. Compatible across nearly all Windows platforms, if you can print from a windows application you can use pdfMachine.

Get yours now!

- kontaktuar Drejtorin e Drejtorisë për Urbanizëm në Komunën e Mitrovicës/Mitrovica lidhur me çështjen e njëjtë.
13. Më 21 tetor 2005, ish-Ombudspersoni i dërgoi një letër përkujtuese Drejtorit të Drejtorisë për Urbanizëm në Komunën e Mitrovicës/Mitrovica, duke kërkuar nga ai që të përgjigjet në letrën e datës 9 shtator 2005. Ish-Ombudspersoni kërkoj që të merr informata lidhur me rastin e ankuesit, jo më vonë se deri më 3 nëntor 2005.
 14. Më 31 tetor 2005, ish-Ombudspersoni pranoi një përgjigje nga Drejtori i Drejtorisë për Urbanizëm në Komunën e Mitrovicës/Mitrovica, në të cilën ai theksoi se në kohën kur ankuesi ka paraqitur kërkesën në drejtorinë e lartpërmendur, nuk ishte e qartë se cila drejtori ishte kompetente për t'u marrë me çështjen e ankuesit. Më vonë, ishte vendosur përfundimisht se çështja ishte nën juridiksion të Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim.
 15. Më 16 janar 2006, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit i dërgoi një letër Drejtorit të Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim, duke iu referuar letrës që e ka pranuar nga Drejtori për Urbanizëm në Komunën e Mitrovicës/Mitrovica, më të cilën e njoftoi Drejtorin e Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim lidhur me ankesën në fjalë. Një kopje e kësaj letrë i është dërguar edhe Kryeshefit Ekzekutiv të Komunës. Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit kërkoj informata lidhur me rastin e ankuesit, por jo më vonë se deri më 3 shkurt 2006. Nuk kishte asnjë përgjigje në këtë letër.
 16. Më 13 shkurt 2006, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit i dërgoi një letër Ministrin për Qeverisje Lokale, me të cilën e informoi atë se autoritetet komunale në Mitrovicë/Mitrovica kanë dështuar t'i përgjigjen letrës së tij dhe kërkoj nga ai që ta sigurojë se një praktikë e tillë do të ndërpritet, dhe në këtë mënyrë Institucioni i Ombudspersonit do të mund t'i marrë informatat e kërkuara. Një kopje e kësaj letrë i është dërguar Koordinatorit për Standarde në Qeverinë e Kosovës dhe Kryetarit të Komunës së Mitrovicës/Mitrovica. Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit asnjëherë nuk pranoi ndonjë përgjigje në këtë letër.
 17. Më 25 gusht 2006, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit i dërgoi letër përkujtuese Drejtorit të Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim në Komunën e Mitrovicës/Mitrovica, me të cilën kërkoj nga ai që t'i përgjigjet letrës së tij të datës 1 janar 2006. Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit kërkoj që të merr informata lidhur me rastin e ankuesit, por jo më vonë se deri më 8 shtator 2006..
 18. Më 11 tetor 2006, pasi që nuk pranoi asnjë përgjigje në letrën e tij të 25 gushtit 2006, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit i dërgoi letër Kryetarit të Komunës së Mitrovicës/Mitrovica, me të cilën e informoi se ishte përpjekur ta kontaktojë Drejtorin e Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim lidhur me çështjen e ankesës. Në këtë letër, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit kërkoj nga Kryetari i Komunës që të sigurojë se praktika e mospërgjigjes në letrat e Institucionit të Ombudspersonit të ndryshohet, në mënyrë që Institucioni i Ombudspersonit të

kërkoi që të merr informata lidhur me rastin e ankuesit por jo më vonë se deri më 25 tetor 2006.

19. Më 16 mars 2007, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit i dërgoi letër Drejtorit të Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim në Komunën e Mitrovicës/Mitrovica, ku kërkoi nga ai që të përgjigjet në letrat e mëparshme. Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit kërkoi informata jo më vonë se deri më 23 mars 2007. Nuk kishte kurrfarë përgjigje në këtë letër.
20. Më 11 prill 2007, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit zyrtarisht hapi hetimet për këtë rast (Regjistrimi nr. 1936/07).

INSTRUMENTET RELEVANTE

21. Rregullorja e UNMIK-ut 1999/24 (më 12 dhjetor 1999) mbi ligjin e zbatueshëm në Kosovë, e ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2000/59 (më 27 tetor 2000) (në tekstin e mëtejshëm, Rregullorja e UNMIK-ut 2000/59), në pjesën përkatëse, thotë:

1.1 Ligji i zbatueshëm në Kosovë do të jenë:

(a) Rregulloret e shpallura nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm dhe instrumentet ndihmëse të lëshuara lidhur me to; dhe
[...]

22. Rregullorja e UNMIK-ut 2000/45 mbi Vetëqeverisjen e Komunave në Kosovë (11 gusht 2000) (në tekstin e mëtejshëm, Rregullorja e UNMIK-ut 2000/45) në pjesën përkatëse, thotë:

Neni 3

Përgjegjësitë dhe pushteti i komunave

3.1. Çdo komunë brenda territorit të vet dhe brenda ligjeve ekzistuese që rregullojnë secilin aktivitet është përgjegjëse për aktivitetet vijuese:

- (a) Ofrimin e kushteve themelore lokale për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik;
- (b) Planifikimin urban dhe të fshatit dhe shfrytëzimin e tokës;
- (c) Lëshimin e lejeve për ndërtim dhe zhvillime të tjera;
- (d) Mbrojtjen lokale të ambientit;
- (e) Zbatimin e rregullave të ndërtimit dhe kontrollimin e standardeve të ndërtimit;
[...]
- (i) Shkollimin parashkollor, fillor dhe të mesëm;

pdfMachine

Is a pdf writer that produces quality PDF files with ease!

Produce quality PDF files in seconds and preserve the integrity of your original documents. Compatible across nearly all Windows platforms, if you can print from a windows application you can use pdfMachine.

Get yours now!

të territorit komunal, që nuk janë të përcaktuar gjetiu me ligj.

[...]

23. Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2004/50 mbi Themelimin e Ministrive të Reja dhe Krijimi i Posteve të Zëvendës Kryeministrit dhe të Zëvendës Ministrave në Degën e Ekzekutivit, (4 dhjetor 2004) (në tekstin e mëtejshëm Rregullorja e UNMIK-ut 2004/50) në pjesën përkatëse, thotë:

Neni 1

Ministritë e reja

1.1 Në degën e ekzekutivit të institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes krijohen këto ministri të reja:

[...]

(c) Ministria për Administratën e Qeverisjes Lokale. Kjo ministri është përgjegjëse për çështjet që ndërlidhen me ngritjen e efektivitetit të vetëqeverisjes lokale. Në ushtrimin e kompetencave të veta për qeverisje lokale efektive, ministria është përgjegjëse për të siguruar ofrimin e shërbimeve publike të kontrolluara nga niveli qendror për plotësimin e nevojave të të gjitha komuniteteve dhe sigurimin e qasjes së barabartë në shërbimet e tilla.

1.2 Përgjegjësitë e detajuara dhe funksionimi i ministrive nga neni 1.1 do të përcaktohen në një rregullore të mëvonshme me të cilën do të ndryshohet Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/19. Ministritë i marrin kompetencat dhe përgjegjësitë e tyre përkatëse pas hyrjes në fuqi të Rregullores me të cilën ndryshohet Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/19. Deri atëherë kompetencat dhe përgjegjësitë në fjalë vazhdojnë të ushtrohen nga autoritetet dhe subjektet që aktualisht kanë përgjegjësi për kryerjen e tyre. [...]

24. Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2001/19 Mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë (13 shtator 2001) në pjesën përkatëse, thotë:

[....]

Shtojca IV

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë

Ministria:

- (i) Krijon politikën e veprimit dhe zbaton legjislacionin për zhvillimin e

pdfMachine

Is a pdf writer that produces quality PDF files with ease!

Produce quality PDF files in seconds and preserve the integrity of your original documents. Compatible across nearly all Windows platforms, if you can print from a windows application you can use pdfMachine.

Get yours now!

- (ii) Përkrah një sistem arsimor jo diskriminues, ku respektohet e drejta e çdo personi për shkollim dhe ku mundësitë për mësim cilësor janë në dispozicion të të gjithëve;
- (iii) Ofron arsim joformal dhe arsim për të rriturit në të gjitha nivelet, duke përfshirë rajonet e largëta dhe përkrah mundësitë e shkollimit të përjetshëm për të gjithë;
- (iv) Përpilon, zbaton dhe mbikëqyr format e drejta dhe efektive të administratës arsimore dhe menaxhimit shkollor;
- (v) Përmirëson cilësinë, lidhjen dhe efikasitetin e arsimit në të gjitha nivelet;
- (vi) Ndihmon zhvillimin dhe përmirësimin cilësor të sistemit arsimor dhe shpërndarjen e shërbimeve arsimore;
- (vii) Përkrah hulumtimin lidhur me zhvillimin social, ekonomik, shkencor, teknologjik dhe kulturor të Kosovës.
- (viii) Ndërton një sistem gjithëpërfshirës bibliotekar, i cili do të përfshijë bibliotekat e posaçme dhe ato shkollore;
- (ix) Përkrah një politikë gjithëpërfshirëse për integrimin e personave të paafte dhe të hendikepuar;
- (x) Përkrah pjesëmarrjen e prindërve dhe të komunave në aktivitetet arsimore dhe në format përkatëse të bashkëpjesëmarrjes shkollë-komunitet në të gjitha nivelet.

25. Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë, e shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut 2001/09 më 15 maj 2001 në pjesën përkatëse, thotë

[...]

10.1 Personat fizikë dhe juridikë kanë të drejtë, pa pasur frikë apo kërcënim për masë ndëshkimore, të bëjnë ankesa pranë një zyre të pavarur në lidhje me shkeljet e të drejtave të njeriut dhe veprimeve që përbëjnë shpërdorim të pushtetit nga çfarëdo organi publik i Kosovës.

10.2 Zyra e Ombudspersonit, në pajtim me legjislacionin e UNMIK-ut në fuqi, ka juridiksion të marrë dhe të hetojë ankesa, të vëzhgojë, të marrë masa parandaluese, të bëjë rekomandime dhe të jep këshilla për çdonjërin prej këtyre çështjeve. [...]

26. Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/6 mbi Institucionin e Ombudspersonit në Kosovë (16 shkurt 2006), në pjesën përkatëse, thotë:

[...]

3.1 Institucioni i Ombudspersonit ka kompetenca për të pranuar dhe hetuar ankesat nga çdo banor i përhershëm i Kosovës apo nga person fizik a juridik në territorin e Kosovës lidhur me shkeljen e standardeve ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut të përfshira në ligjin dhe aktet në fuqi, duke përfshirë këtu edhe mosndërmarrjen e veprimeve, që përbëjnë keqpërdorim të pushtetit nga institucionet e Kosovës. [...]

4.6 Institucioni i Ombudspersonit i ndërmerr të gjitha hapat dhe veprimet e nevojshme për t'i shqyrtuar ankesat e parashtruara sipas nenit 3.1, duke përfshirë këtu edhe intervenimin e drejtpërdrejtë tek autoritetet kompetente, nga të cilët do të kërkohet që të përgjigjen brenda kohës së arsyeshme. Nëse vazhdon dëmi i rëndë si pasojë e çështjes së ankesës nga neni 3.1, nga autoritetet kompetente kërkohet që të përgjigjen me nguti. [...]

4.8 Institucioni i Ombudspersonit ka qasje në dosjet dhe dokumentet e çdo institucioni të Kosovës dhe mund t'i shqyrtojë ato lidhur me rastet që i ka në shqyrtim dhe sipas kësaj Rregulloreje, mund të kërkojë nga çdo institucion i Kosovës dhe nga personeli i tyre që të bashkëpunoj me institucionin e Ombudspersonit, duke siguruar informacione relevante, dokumente dhe dosje. Ndonjë institucion i Kosovës mund të refuzojë dhënien e dosjeve ose dokumenteve Institucionit të Ombudspersonit në rrethanat në të cilat, në pajtim me legjislacionin në fuqi lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale, refuzimi i dhënies së dokumentit të Ombudspersonit shprehimisht është i lejuar, me kusht që arsyet t'i paraqiten Institucionit të Ombudspersonit me shkrim. Institucioni i Ombudspersonit mund të nxjerr konkludime të tilla që nga refuzimi i dhënies së dosjeve ose dokumenteve i sheh të përshtatshme. [...]

ANALIZA

27. Ombudspersoni konsideron se dështimi i autoriteteve komunale në Skenderaj/Sërbica dhe Mitrovicë/Mitrovica për të bashkëpunuar me Institucionin e Ombudspersonit ngritë çështje serioze sipas ligjit të zbatueshëm në Kosovë. Neni 10.2 i Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/19 mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë, në pjesën përkatëse, përcakton se:

[...] “Zyra e [Ombudspersonit], në pajtim me legjislacionin e UNMIK-ut në fuqi, ka juridiksion të pranojë dhe të hetojë ankesa, të vëzhgojë, të marrë masa parandaluese, të bëjë rekomandime dhe të jep këshilla për çdonjërin prej këtyre çështjeve.
[...]

28. Rregullorja e UNMIK-ut 2006/6 mbi Institucionin e Ombudspersonit në Kosovë, në pjesë përkatëse, përcakton:

Neni 3.1

Ombudspersoni ka të drejtë ligjore për të pranuar dhe hetuar ankesat e çdo personi apo subjekti në Kosovë që kanë të bëjnë me shkeljen e të drejtave të njeriut dhe veprat që paraqesin keqpërdorim të pushtetit nga ana e Administratës së Përkohshme Civile apo nga cilido institucion qendror a lokal që mund të paraqitet. [...]

Neni 4.6

Ombudspersoni do t'i ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për t'i shqyrtuar të gjitha ankesat e bëra në bazë të nenit 3.1, duke përfshirë edhe intervenimin e drejtpërdrejtë te autoritetet përkatëse, të cilat duhet të përgjigjen brenda një afati të arsyeshëm kohor. [...]

Neni 4.8

Ombudspersoni [...] mund të kërkojë nga cilido person që të bashkëpunojë me të për t'i dhënë informata, dokumente dhe dosje përkatëse [...]

29. Bazuar në atë që u tha më lartë, Ombudspersoni mund t'i drejtohet autoriteteve publike dhe të kërkojë nga ato që të intervenojnë në raste të veçanta apo të suspendojnë ekzekutimin e vendimeve të veta. Ai gjithashtu mund të kërkojë nga ta informata, dokumente apo qasje në dosje të caktuara.
30. Sipas rregulloreve të lartpërmendura, autoritetet publike, përfshirë këtu edhe Drejtorin e Drejtorisë për Arsim në Komunën e Skenderajt/Sërbica, Kryetarin e Komunës së Skenderajt/Srbica, Drejtorin e Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim në Komunën e Mitrovicës/Mitrovica, Kryeshëfin e Ekzekutivit në Komunën e Mitrovicës/Mitrovica dhe Kryetarin e Komunës së Mitrovicës/Mitrovica, kanë obligime të caktuara që të ndihmojnë Ombudspersonin në punën e tij. Në veçanti, ato janë të obliguara t'i përgjigjen kërkesave të tij brenda një afati kohorë të arsyeshëm dhe t'i sigurojnë atij çfarëdo informatë, dokument apo dosje të cilat i kërkon.
31. Ndërmjet muajve shtator 2005 dhe mars 2007, ish-Ombudspersoni dhe më vonë edhe Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit, gjatë zhvillimit të hetimeve në rastet kundër Komunës së Skenderajt/Srbica dhe komunës së Mitrovicës/Mitrovica, kanë dërguar një numër të letrave këtyre autoriteteve. Në rastin e Komunës së Skenderajt/Srbica, letrat janë dërguar më 16 shtator 2005, më 25 nëntor 2005 dhe më 23 dhjetor 2006 dhe përfaqësuesit e Institucionit të Ombudspersonit, disa herë, kanë kontaktuar drejtpërdrejt me zyrtarët kompetentë komunalë. Për një kohë të gjatë, nuk kishte përgjigje në kërkesat e Institucionit të Ombudspersonit, ndërsa në pranverë të vitit 2007, Drejtori i Drejtorisë për Arsim, dy herë iu përgjigj kërkesave gojore të stafit të Institucionit të Ombudspersonit, duke thënë se nuk kishte kurrfarë informatash lidhur me rastin.
32. Në rastin e Komunës së Mitrovicës/Mitrovica, letrat i janë drejtuar autoriteteve kompetente më 9 shtator 2005, më 21 tetor 2005, më 16 janar 2006, 25 gusht 2006, më 11 tetor 2006 dhe më 16 mars 2007, por asnjëherë nuk janë përgjigjur në këto intervenime apo kërkesa për informata, duke mos marrë parasysh as edhe disa letra përkujtuuese dhe kërkesa gojore (shih para. 15, 17, 18 dhe 19 sipër).
33. Ombudspersoni vëren se Ministri për Qeverisje Lokale, ministrat tjerë kompetentë

pdfMachine

Is a pdf writer that produces quality PDF files with ease!

Produce quality PDF files in seconds and preserve the integrity of your original documents. Compatible across nearly all Windows platforms, if you can print from a windows application you can use pdfMachine.

Get yours now!

mungesën e këtij bashkëpunimi nga ana e autoriteteve në komunën e Skenderajt/Srbica dhe të Mitrovicës/Mitrovica (shih para. 16 sipër). Sidoqoftë, përkundër funksioneve mbikëqyrëse të ministrive përkatëse, asnjëri nga organet qendrore nuk iu përgjigj kërkesave të Ombudspersonit, as nuk kishte ndonjë të dhënë se ata kishin ndërmarrë ndonjë veprim për të përmirësuar bashkëpunimin e komunave të Skenderajt/Srbica dhe të Mitrovicës/Mitrovica me Institucionin e Ombudspersonit.

Konkluzion

34. Në rastin e autoriteteve në Komunën e Skenderajt/Sërbica, gjegjësisht të Drejtorit të Drejtorisë për Arsim dhe të Kryetarit të Komunës, Ombudspersoni konsideron se dështimi i vazhdueshëm për t'iu përgjigjur letrave të ish-Ombudspersonit dhe të Ushtruesit të Detyrës së Ombudspersonit gjatë një periudhe kohore prej një viti e gjysmë, ishte në kundërshtim me obligimet e autoriteteve komunale sipas Nenit 4.6 dhe 4.8 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/06. Madje edhe kur është kontaktuar drejtpërsëdrejti, Drejtori i Drejtorisë për Arsim në këtë komunë, thjesht është përgjigjur se ai nuk kishte informata lidhur me rastin. Përderisa, Ombudspersoni e ka vështirë të besojë për vendimin e dhënë nga ana e Komisionit Komunal për Ankesa kundër tij, ai më tej vëren se Drejtori i kësaj drejtorie nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për të hetuar rastin dhe për t'i siguruar Institucionit të Ombudspersonit informatat e duhura lidhur me rastin. Prandaj, ai është sjellë në mënyrë mospërfillëse dhe ka vazhduar të zvarrisë hetimet e zhvilluara nga Institucioni.
35. Në rastin e autoriteteve në Komunën e Mitrovicës/Mitrovica, gjegjësisht të Drejtorit të Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim, Kryeshefit të Ekzekutivit dhe të Kryetarit të Komunës, Ombudspersoni vëren se me dështimin për t'iu përgjigjur të gjitha letrave të pranuar nga ish-Ombudspersoni dhe nga Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit gjatë një periudhe kohore prej një viti e gjysmë, këto autoritete, gjithashtu nuk i kanë zbatuar obligimet e veta si autoritete publike ndaj Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë, në bazë të neneve 4.6 dhe 4.8 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/6, dhe kështu kanë shkelur dispozitat e lartpërmendura.
36. Më në fund, sa i përket mosveprimit të autoriteteve qendrore qeveritare, fillimisht Ministria për Qeverisje Lokale, dhe në rastin e Komunës së Skenderajt/Srbica, Ministria për Arsim, Shkencë dhe Teknologji, Ombudspersoni konstaton se dështimi për të siguruar që autoritetet përkatëse komunale t'i përmbushin obligimet e tyre sipas ligjit dhe të bashkëpunojnë me Institucionin e Ombudspersonit përbën një shkelje të obligimeve të tyre për të mbikëqyrur administratën lokale që është nën kompetencat e tyre, siç është rregulluar me Rregulloren e UNMIK-ut 2004/50 mbi ministrinë e reja dhe krijimin e posteve të Zëvendës Kryeministrit dhe të Zëvendës Ministrave në Degën e Ekzekutivit, dhe në shtojcën IV të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/19 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë respektivisht.

REKOMANDIMET

37. Ombudspersoni rekomandon që Ministri për Qeverisje Lokale dhe Ministri për Arsim, Shkencë dhe Teknologji duhet që, jo më vonë se më **22 qershor 2007**:

- Të sigurojë që Kryetari i Komunës së Skenderajt/Srbica dhe Kryetari i Komunës së Mitrovicës/Mitrovica dhe nëpunësit e tyre të përgjigjen pa ndonjë vonesë të mëtejme në kërkesat e mëparshme dhe në ato të ardhshme si dhe në intervenimet e Institucionit të Ombudspersonit,
- Të sigurojë që kopjet e këtij raporti të shpërndahen në të gjitha drejtoritë e të gjitha komunave në Kosovë,
- Të informojë Ombudspersonin lidhur me çdo veprim të ndërmarrë si përgjigje në këtë raport, të lëshuar në pajtim me Nenin 16.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/06 mbi Institucionin e Ombudspersonit në Kosovë.

Hilmi Jashari
Ushtues i Detyrës së Ombudspersonit

pdfMachine

Is a pdf writer that produces quality PDF files with ease!

Produce quality PDF files in seconds and preserve the integrity of your original documents. Compatible across nearly all Windows platforms, if you can print from a windows application you can use pdfMachine.

Get yours now!